



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO		
QEVERIA E KOSOVËS Ministria e Shëndetësisë	GOVERNMENT OF KOSOVO Ministry of Health	VLADA KOSOVA Ministarstvo zdravstva

Udhëzim Administrativ (MSH) Nr.12/2006

Për licencim të përkohshëm të profesionistëve shëndetësor qytetar jo-kosovar .

1. Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë me Rregulloren nr.2001/119
2. Të datës 13 shtator 2001, në veçanti me shtojcën 6, paragrafin (iii), që të përpilojë norma e standarde dhe të nxjerrë udhëzime për sektorin e shëndetësisë në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe paragrafin (iv) që të mbikëqyrë respektimin e këtyre normave dhe standardeve;
3. Me qëllim të riorganizimit dhe fuqizimit të Organit për regjistrim dhe dhënie e lejeve të punës për profesionistët shëndetësor të formuar me Udhëzimin Administrativ (në shëndetësi) (numri i ndryshuar i UA10/2003 me plotësimin e aprovuar),
4. Me qëllim të implementimit të UA për licencim të përkohshëm të profesionistëve shëndetësor qytetar jo-kosovar;
5. Të vendosur për udhëheqjen efektive të kuadrit profesional brenda sektorit të shëndetësisë,

Dispozita të përgjithshme Neni 1

- 1.1 Me këtë Udhëzim Administrativ rregullohet procedura dhe kushtet e marrjes së lejes së përkohshme të punës të profesionistëve shëndetësor qytetar jo-kosovar.
- 1.2 Të gjithë profesionistët shëndetësor qytetar jo-kosovar që kohë pas kohe, jo më shumë se dy muaj gjatë një viti kalendarik, ushtrojnë veprimtari shëndetësore në Kosovë në sektorin



publik dhe privat shëndetësor, e që nuk kanë vendqëndrim të përhershëm duhet të aplikojnë për marrje të lejes së përkohshme të punës në MSH gjegjësisht Bordin për regjistrim dhe licencim të profesionistëve shëndetësor

- 1.3 Kohëzgjatja e lejes së përkohshme nga pika 1.1 e këtij UA është jo më shumë se 30 ditë pune brenda vitit kalendarik;
- 1.4 Pasi që bëhet fjalë për vendqëndrim të përkohshëm, nga profesionistët shëndetësor nga pika 1.1 e këtij UA nuk do të kërkohet barasvlerësimi dhe nostrifikimi i kualifikimeve profesionale.
- 1.5 Profesionistët shëndetësor qytetar jo-kosovar, të cilët ofrojnë shërbime në kohë më të gjatë se ajo që është paraparë në nenin 1.3 i nënshtrohen procedurës së regjistrimit dhe licencimit ashtu si është paraparë me nenin 5 paragrafin 5.1 të UA 10/2003.

Parashtrimi i kërkesës

Neni 2

- 2.1 Institucioni shëndetësor publik apo privat e i licencuar nga MSH, që angazhon profesionistin shëndetësor qytetar jo-kosovar, ka për obligim të parashtoj kërkesën për leje të përkohshme pune;
- 2.2 Kërkesës duhet bashkëgjatur :
 - Licencën për kryerje të veprimtarisë shëndetësore të institucionit shëndetësor
 - Kualifikimet e profesionistit shëndetësor qytetar jo-kosovar (diplomën e fakultetit dhe specializimit, dhe kualifikimet tjera profesionale)
 - Licencën e punës profesionale e lëshuar nga organet kompetente të vendit nga vjen profesionisti;
 - Dëshmi (vërtetim) për përvojën profesionale dhe institucionin ku punon nga shteti i prejardhjes;
 - Vërtetim për rregullimin e vendbanimit të përkohshëm në Kosovë.
 - Paraqitja e dëshmisë mbi pagën e taksës administrative për leje të përkohshme të punës;
 - Fotokopjen e dokumentit identifikues
 - Kërkesës për leje të përkohshme duhet të i bashkëngjitet origjinali dhe fotokopja e origjinalit të përkthyer në mënyrë zyrtare të vërtetuar nga përkthyesi zyrtar

Lëshimi i lejes së përkohshme

Neni 3

- 3.1 Bordi Qendror për Regjistrim dhe Licencim ka për obligim që në afat prej tetë ditësh nga parashtrësja e kërkesës të shqyrtoj kërkesën dhe po qe se konstaton se kushtet nga neni paraprak janë përmbushur, të lëshoj vendimin për lejen e përkohshme të punës.
- 3.2 Bordi kujdeset që profesionisti shëndetësor qytetar jo-kosovar të mos tejkaloj afatin e lejes nga neni 1.3 i këtij UA.
- 3.3 Bordi mban regjistrin e veçantë për këtë kategori të profesionistëve shëndetësor;
- 3.4 Bordi për regjistrim dhe licencim të profesionistëve shëndetësor i propozon Zyrës Ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë ndërmarrjen e masave në bazë të ligjeve përkatëse me rastin e tejkalimit të afatit të lejes nga neni 1.3 të këtij UA sipas dispozitave të nenit 5 ;

**Përgjegjësia
Neni 4**

- 4.1 Ministria e Shëndetësisë nuk është përgjegjëse për dëmet eventuale që mund të shkaktohen nga aktiviteti i profesionistit shëndetësor shtetas të huaj të angazhuar
- 4.2 Institucioni që angazhon profesionistin shëndetësor qytetar jo -kosovar, është përgjegjës për dëmin eventual që u shkaktohet klientëve gjatë trajtimit të tyre.

**Dispozitat ndëshkimore
Neni 5**

- 5.1 Institucioni shëndetësor që ka punësuar profesionistin shëndetësor qytetar jo -kosovar pa leje të përkohshme pune do të gjohet:
 1. Institucioni me gjobë prej 3000 – 5000 euro;
 2. Punëtori shëndetësor prej 500 - 1000 euro;
- 5.2 Nëse edhe pas shqiptimit të gjobës dhe afatit të dhënë për nxjerrjen e lejes së përkohshme (15 ditë nga dita e shqiptimit të masës nga pika 5.1) institucionit i shqiptohet masa:
 1. tërhiqet licenca e punës në kohëzgjatje prej një viti;
 2. profesionistit shëndetësor i tërhiqet licenca e punës në kohëzgjatje prej një viti;

**Hyrja në fuqi
Neni 6**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Ministri i Shëndetësisë.

Prishtinë,
08.09.2006



Sadik Idrizi
Prof. Sadik Idrizi

ADMINISTRATIVNO UPUSTVA (M Z) br.12/2006

ZA PRIVREMENO IZDAVANJE DOZVOLA ZDRAVSTVENIM STRANIH STRUČNJAKA

1. Shodno ovlasčenju datom Ministarstvu po Pravilniku br.2001/119;
2. Od dana,13.09.2001, posebno u dodatku 6,tačka (iii) da razvija norme i standarde i da donosi upustvo za zdravstveni sektor u skladu sa međunarodnim standardima i tačka (i.v) da nadgleda pridržavanje ovih normi i standarda;
3. U cilju da reorganizuje i učvrsti Organ za registraciju i izdavanje radnih dozvola za zdravstvene stručnjake kako je određeno administrativnim upustvom(u zdravstvo)sa usvojenom izmenom AU 10/2003;
4. Sa ciljem implementacije AU za privremeno izdavanje dozvola zdravstvenim strani stručnjaka(strani državljanin);
5. Odluceno da efikasno upravlja zdravstvenim osobljem u okviru zdravstvenog sektora.

OPŠTE ODREDBE

Č LAN 1.

- 1.1 Ovo Administrativno Upustvo reguliše način i uslove za izdavanje privremene dozvola rada zdravstvenim stranih stručnjacima;
- 1.2 Svih strani zdravstvenih stručnjacima koji privremeno rade,ne više od 2 meseca u toku kalendarske godine za obavljanje samostalne zdravstvene delatnosti na Kosovo, u javnom i privatnom zdravstvenom sektoru , a koji nemaju stalno boravište , moraju da dostave zahtev za dobijanje privremene dozvola rada u MZ ,odnosno Bord za registraciju i izdavanje dozvola zdravstvenim stručnjacima;
- 1.3. Privremena dozvola pod tačkom1.1 ove AU nema važnost više od 30 dana u toku godine.
- 1.4.S obzirom da se radi o privremenom boravište od zdravstvenih stručnjaka ,pod tačkom 1.1 ove AU neće se tražiti nostrifikacija za profesionalno kvalifikacije;
- 1.5.Stranih zdravstveni stručnjaci koji zahtevaju uslugu u dužem roku u odnosu na predviđenom čl.1.3. podleže proceduri registracije i izdavanje dozvole , kao što je predviđeno čl.5.tačka 5.1 AU .10/2003.

ČLAN 2

2.1. Zdravstvena Javna Institucija, ili privatna, licencirana od MZ, koja angažira stranog zdravstvenog stručnjaka, dužna je da dostavi zahtev za privremenu dozvolu rada;

2.2. Sa zahtevom mora se priložiti:

- Licencu za obavljanje zdravstvenog delatnosti i zdravstvenog institucija;
- Zdravstvene profesionalne kvalifikacije (diplomu fakulteta i specijalizacija kao i druge stručne kvalifikacije);
- Licenca (dozvola) stručnog rada izdato od nadležnog organa mesta (države) odakle dolazi zdravstveni stručnjak;
- Potvrdu o stručnom iskustvom institucije od države odakle dolazi
- Potvrdu o mestu privremenog boravka na Kosovo;
- Dostavi potvrdu o plaćenom administrativnog takse za privremenu dozvolu rada;
- Lična karta (fotokopirana);
- Zahtev za privremeni rad mora se priložiti original i fotokopirana, službeno preveden takođe verifikovana od strane službenog prevodioca.

IZDAVANJE PRIVREMENE DOZVOLE.

ČLAN 1

3.1 Centralni bord za registraciju i izdavanje dozvole, dužan je u roku od 8 dana od dostave zahteva da razmatra zahtev i u slučaju da su ispunjeni uslovi po prethodnom članu da izdaje rešenje o privremenu radu.

3.2 Bord nastoji da zdravstvenih strani stručnjak da ne prevaziđe rok dozvole po čl.1.3 ove AU.

3.3 Bord drži posebnu evidenciju za ovu stručnu kategoriju.

3.4 Bord za registraciju i izdavanje (licenciranje) zdravstvenih stručnjaka predlaže Pravnoj Službi u Ministarstvo Zdravstva da preduzima mere nosnovu zakonski propise u slučaju prekoračenje roka (dozvole) po čl.1.3 ove AU poodredbama čl.

ODGOVORNOST

ČLAN 4

- 4.1 Ministarstvo Zdravstva nije odgovorna u slučaju eventualne štete učinjeno od zdravstvenog stručnjaka stranog državljanstva koji je angažiran.
- 4.2 Institucija koja angažira zdravstvenog stručnjaka odgovorna je za eventualnu štetu učinjeno prilikom negovanja bolesnicima.

KAZNENE ODREDBE

ČLAN 5

5.1 Zdravstvena Institucija koja je zaposlila stranog zdravstvenog radnika bez privremene dozvole za rad dobiće sledeće kazna

1. Institucija dobiće kaznu (novčanu) od 3000-5000€
2. Zdravstveni radnik od 500-1000€

5.2 Nakon izrečene kazne i određivanje roka za dobijanje privremene dozvole (15 dana od dana izrečene kazne pod tač. 5.1) Instituciji se izručuje sledeće mere:

1. Oduzima se licenca rada u roku od god. dana;
2. Zdravstvenog stručnjaku oduzima se licenca rada u roku od 1 god.

STUPA U SNAGU

ČLAN 6

Ovo Administrativno Upustvo stupa u snagu na dan njegovog potpisivanja od MINISTRA ZDRAVSTVA.

Priština,

8.09.2006

MINISTAR ZDRAVSTVA

Prof. Sadik Idriz